



BPrAL - PPOHE  
**Kolegji AAB**

**DEGA - GJAKOVË**

***DREJTIMI: MENAXHMENT DHE INFORMATIKË  
& MARKETING DHE ADMINISTRIM BIZNESI***

**Lënda:**

**INFORMATIKA E BIZNESIT**

**Mësimdhënësi**

***MSc.Florent Bunjaku, PhD cand.***

1

**Viti akademik 2014/2015**


# *PROTOKOLET*

Rregullat të cilat përcaktojnë mënyrën e komunikimit në rrjet të kompjuterëve në mes veti quhen *protokole*. Ekzistojnë protokole të ndryshme që u janë përshtatur kompjuterëve, rrjetave dhe topologjive të ndryshme.

Protokoli në të vërtetë paraqet gjuhën e cila u mundëson kompjuterëve që të *komunikojnë njëri me tjetrin*.

# *PROTOKOLET E INTERNETIT*

Me anë të protokoleve arrihet lidhja në mes të kompjuterëve personalë dhe qendrës së madhe kompjuterike. Softveri i cili mundëson funksionimin normal të Internetit përbëhet nga dy komponente të protokoleve të cilat sipas standardeve ndërkombëtare quhen:




## Çka ka për detyrë protokoli TCP?

Protokoli TCP ka për detyrë organizimin dhe shpërndarjen e të dhënave në pakete të cilat duhen dërguar në rrjet.

## Çka ka për detyrë protokoli IP?

Protokoli IP ka për detyrë bartjen e tyre nëpër rrjet, siguron adresat e kompjuterëve, si dhe rrugëtimin e paketeve, që në terminologjinë kompjuterike quhet rutinë (routing). Secili rrjet kompjuterik dhe secili kompjuter i ndërlidhur në rrjet – i ashtuquajtur host i internetit, merr një adresë të veçantë të protokolit të Internetit (IP), p.sh. 129.144.50.56.



Hostet e internetit janë të organizuar poashtu edhe me emra të domeneve: p.sh. “microsoft.com” është domen i firmës Microsoft Corporation, kurse prapashtesa “com” tregon se ka të bëjë me organizatë komerciale. Kështu p.sh. “ftp.microsoft.com” është një host i internetit përbrenda atij domeni.

# STANDARDËD PËR KOMUNIKIMIN E KOMPJUTERËVE

**NIC Kartela:** NIC (Network interface card) është kartela përmes të cilit kompjuteri lidhet me rrjetë. Varësisht prej teknologjisë së rrjetit ekzistojnë lloje të ndryshme të NIC kartelave p.sh.

- **Ethernet**
- **Token ring**
- **BNC**

Në të shumten e rasteve përdoren kartelat Ethernet me shpejtësi të transmisionit 10Mb, 100Mb, 1Gb

NIC kartela (Adapteri i rrjetit), kryen këto funksione:

- Pranon shënimet dhe i shëndrron ato në sinjale elektrike
- Pranon sinjalet elektrike dhe i shëndrron ato në shënime
- Përcakton se shënimi i pranuar a i përket kompjuterit adekuat apo jo
- Kontrollon rrjedhjen e shënimeve nëpër medium p.sh. kablllo



*Kartela e rrjetit*

## Modemi

- Modemi është një paisje që i mundëson kompjuterit konvertimin e informatave në tinguj digjital dhe anasjelltas. Kjo ndryshe njihet edhe si modulim dhe demodulim.
- Shpejtësia e modemit matet në bit për sekondë





## Ç'është Interneti

Më së pari duhet sqaruar se në Internet në shumë raste me të njëjtin term nënkuptohet pikëpamja **softuerike** dhe **harduerike** që fare nuk është e njëjtë, por ka të bëjë me të njëjtën gjë. Kështu, Interneti, mund të themi, përbëhet nga lidhja e një numri shumë të madh rrjetash të kompjuterëve të shpërndarë anë e kënd botës. Rrjeti i kompjuterëve duhet kuptuar si lidhje e shumë kompjuterëve në një provajder. Në këtë mënyrë provajderët e lidhur në mes veti formojnë rrjetin e Internetit. Kjo është sa i takon aspektit harduerik. Sa i takon prëmbajtjes së Internetit, atë ndoshta duhet kuptuar si softuer që na siguron disa lloje informacionesh të cilat mund t'i shfrytëzojë secili parapagues i Internetit.

# KYÇJA NË INTERNET

Për kyçje në internet është e nevojshme të sigurohet kjo tersi e pajisjeve teknologjike dhe programeve të komunikimit:

1. Kompjuteri- me kartel grafike, RAM të mjaftueshëm dhe një hard-disk me kapacitet të arsyeshëm, në mënyrë që të ketë hapësirë për shkarkim të informacioneve nga interneti;
2. Linja telefonike- (preferohet linja digjitale e cila karakterizohet me nivel të ulët të zhurmës);
3. Modemi- për realizimin e lidhjes nëpërmjet telefonit ose rrjeti kompjuterik lokal (LAN);
4. Provajderi i internetit (kompania që ofron shërbime të internetit);
5. Brouseri (browser) – programi i cili mundëson paraqitjen në ekran të faqeve të internetit si dhe leximin e informacioneve nga ato faqe

## Furnizuesit me shërbime interneti

Kompania e cila bën të mundur lidhjen e shfrytëzuesit në internet njihet si ofrues i shërbimeve të internetit ose si provajder. Lidhja në internet mund të bëhet edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, por rëndom ajo bëhet nëpërmjet ndonjë provajderi, i cili ofron kyçjen në internet. Bie fjala në Kosovë, ndër provajderë më të njohur të internetit janë: IPKO, KUJTESA, DARDANET etj. Në figurën e mëposhtme është treguar kyçja në internet nëpërmjet lidhjes telefonike



# SHËRBIMET E INTERNETIT

Në internet ofrohen shumë shërbime, të cilat rëndom janë programe të instaluara, disa nga të cilat po i përshkruajmë më poshtë:

1. E- mail,
2. File Transfer Protocol (FTP),
3. Chat,
4. Newsgroups (news),
5. World Wide Web (WWW) etj.

# WWW- World Wide Web

Web-i është përmbajtja më e gjerë që na ofron Interneti. Vetë fjalët World Wide Web kanë domethënien e rrjetit të gjerë botëror (mendohet në informata), që shkurtë njihet me emrin Web. Fjala web do të thotë rrjet marimange. Web-i përbëhet nga lokacione të catuara me përmbajtje specifike të cilat njihem me emrin Web site. Veb sajtet përbëhen nga lokacione më të ngushta të cilat quhen Web page . Në secilin Web site, faqja e parë quhet **Home page** apo faqe amë e cila përbëhet nga faqet Web. Ngjashëm me adresat e shtëpive që janë të njëjta për gjithë botën, ashtu edhe edresa e secilës faqe Web është unike për tërë botën

## Posta elektronike (E-mail)

Posta elektronike (E-Mail) është mënyra e dërgimit dhe e pranimit të porosive të shkruara në kompjuter. Ato mund t'i dërgoni në çdo kompjuter tjetër në botë i cili është i lidhur në ndonjë rrjet kompjuterësh dhe ka llogari (konto) të hapur në ndonjë provajder. Kuptohet, pasi është i lidhur në rrjet ai ka edhe modemin e vet.

Ju duhet ta dini adresën elektronike të kompjuterit që i drejtoheni, ngjashëm me postën klasike nuk mund të dërgoni letër pa adresë

Adresa e shfrytëzuesit përbëhet nga:

1. Emri i shfrytëzuesit,
2. Shenja @,
3. Adresa e kompjuterit (emri i domenit) të mail serverit, në të cilin është i kyçur.

## Domenet

Shumë organizata, institucione, agjensione, servise kanë faqet e tyre Web. Që adresat në Web të dallohen se kujtë i takojnë, në të përmbahen indikatorë të posaçëm të përbërë rëndom nga tri shkronja që quhen *domen (Domain) i nivelit të parë. Domenet e nivelit të parë shënohen me pikë përpara dhe janë:*

- .com – tregon se sajti është pronë e Organizatës komerciale
- .edu – tregon se sajti është pronë e Institucionit arsimor.
- .gov – tregon se sajti është pronë e Organizatës qeveritare.
- .int – tregon se sajti është pronë e Organizatës Ndërkombëtare.
- .mil – tregon se sajti është pronë e armatës së SHBA.
- .net – tregon se sajti është pronë e Serverit të rrjetit.
- .org – tregon se sajti është pronë e Organizata të tjera.

# Adresat elektronike

Adresa elektronike (E-Mail) rëndom paraqitet në këtë mënyrë (emri që propozoni vet një emërtim prej 8 shkronjash, shenja “*et*” – @, *domeni*):

- emri@domeni/
- ku eunet paraqet rrjetin europian të Internetit, ndërsa al domenin e shtetit.
- *Domenet e nivelit të dytë paraqesin shtetin përkatës. P.sh.*
- .al – Shqipëria
- .de – Gjermania
- .it – Italia
- .jp – Japonia




## **Biznesi elektronik**

Zakonisht i quajtur edhe si “eBusiness” apo “e-business”, mund të definojmë aktivitetin i cili përdorë informatat dhe teknologjitë e informacionit (ICT) për përkrahjen e të gjitha aktiviteteve të biznesit. Prefiksi ‘e’ do të thotë *elektronik*.

E-biznesi në mënyrë të theksuar po e ndërron strukturën ekonomike, të tregut dhe të industrisë, vlerat e tregut, produktet dhe shërbimet dhe qarkullimin e tyre, profilizimin e konsumatorëve, sjelljen e konsumatorëve, tregun e punës.

Lidhja në mes të e-business dhe ICT (Informations and Communications Technology – Teknologjia e Informatave dhe e komunikimit) është integral.

E-business nuk mund të ekzistojë pa ICT.



E-biznesi involvon proceset e biznesit të tërë zingjirit të vlerave: blerjet elektronike, menaxhimin e zingjirit të furnizimit, procesimi i porosive në mënyrë elektronike, kujdesin ndaj shërbimeve të konsumatorëve dhe kooperim me partnerët e biznesit.



*Fazat e krijimit të e-biznesit*

# E-commerce

E-commerce është pjesë e e-biznesit që nënkupton mediumin elektronik që përdoret për shitblerjen e produkteve.

Lëmitë e E-Commerce...

Lëmitë e E-Biznesit...

## E-Commerce

- Marketing
- Shitje
- Blerja e produkteve dhe shërbimeve në

## E-Biznesi

- Kompania e dizajnuar për sukses në erën e informatikës
- Krijimi i burimeve të reja të krijimit të vlerave ekonomike
- Zhvillimi i lojalitetit të konsumatorëve
- Optimalizimi i proceseve të biznesit
- Krijimi i produkteve të reja dhe shërbimeve
- Menagjimi i riskut dhe ankesave
- Krijimi i tregjeve të reja
- Zhvillimi i teknologjive të reja
- Zhvillimi i menagjimentit në kushte të reja
- Zhvillimi i Internetit

## Për një ndërmarrje themi se përdorë e-biznesin si pjesë të afarizmit të saj nëse kryen disa nga këto operacione:

- Komunikon në mënyrë elektronike me **partnerët** e tyre afaristë, konsumatorët dhe furnizuesit.
- Komunikon në mënyrë elektronike me ndërmarrjet tjera për të **porositur** prodhimet dhe shërbimet.
- Shet produktet ose shërbimet me anë të **web faqeve**.
- Përdor teknologjitë e internetit, si World Wide Web (më tutje – web) për të **gjetur informata**, siq janë çmimet dhe shiqimi i produkteve.
- Përdor web-in për **kërkime**, si p.sh. trendet e fundit industriale.
- Përdor web faqet për të **ofruar informata** në lidhje me produktet e saj dhe shërbimet.
- Përdor internetin për **operacionet bankare** online (në rrjetin intranet, extranet ose në Internet), dhe për realizimin e **pagesave**.

## ***Modelet e biznesit elektronik***

Me përdorimin e internetit biznesi elektronik është bërë realitet dhe janë krijuar mundësit për zhvillimin e afarizmit midis ndërmarrjeve pavarësisht se ku ndodhen ato.

Si rezultat i komunikimit me rrjeta janë zhvilluar disa modele të tregtisë elektrike siç janë:

### **Modeli B2B (*business to business*)**

Ofertuesi dhe kërkuesi janë ndërmarrjet apo firmat-personat juridik.


Biznesi me këto modele lidhet në mënyrë të planifikuar në bazë të marrveshjes së paraprakisht të definuar

Rritet mundësia e parashikimit të reagimit dhe sjelljes së pjesëmarrësve në Biznes

# Modeli B2C (*business to customer*)

Modeli i Biznesit të firmës me konsumator të fundëm  
(eng. bussines-to costumer B2C)

□ Firma përmes web faqes të vet ju ofron në shitje – konsumatorëve individual (personave fizik),



## Modeli C2C (*customer to customer*)

Biznesi në mes të individëve (Eng.Customer-to-Costumer, C2C)


Pjesëmarrësit janë personat fizik kurse në ndonjë firmë lajmërohen si ndërmjetsues pasiv të cilët ofrojnë infrastrukturen dhe aplikacionin për kontraktim dhe kryerjen e punëve.

□ P.sh. Ankandet në Internet- (ebay, [www.ebay.com](http://www.ebay.com))





# Modeli C2B (*customer to business*)



# MODELI I BIZNESIT SIPAS KRITEREVE PJESËMARRËSVE NË BIZNES

	Business	Customer	Government
Business	<b>B2B</b> conisint.com	<b>B2C</b> dell.com	<b>B2G</b> lockheedmartin.com
Customer	<b>C2B</b> priceline.com	<b>C2C</b> ebay.com	<b>C2G</b> eGov.com
Government	<b>G2B</b> export.gov	<b>G2C</b> medicare.gov	<b>G2G</b> disasterhelp.gov